



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KONTRAKTOR
BASHKIA MALLAKASTËR

Nr. _____ Prot.

Ballsh, më ____ . ____ . 2022

Lënda: **Formulari i Njoftimit të Fituesit**

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK - TIRANË
(për publikim në SPE dhe buletin e njoftimeve publike)

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
BASHKIA MALLAKASTËR

Data 10.10.2022

Drejtuar: **“ZEQIRI” Shpk**, me NIPT J67902827A, me adresë qendrore sipas QKB: Lagjja “Bishanak”, Rruga “Skenderbeu”, Zona Kadastrale 5532, Banese private, Pasuria nr. 1/1088, Kati I-re, FIER

*** * ***

Procedura e prokurimit: **“E hapur e thjeshtuar”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-42596-09-21-2022**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje kontenerë për mbetjet urbane”**, me fond limit **6,666,516** (gjashtëmilion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) **Lekë pa TVSH**

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.131, datë 26 Shtator 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik (OE) “LUAR Bros” Shpk**, me NIPT L72322004M, me ofertë ekonomike në shumën prej **5,866,020** (pesëmilion tetëqind e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e njëzetë) **lekë pa TVSH**.
- 2. Operatori Ekonomik (OE) “N.N.Z.K.Shkodra” Shpk**, me NIPT J66915047G, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,181,200** (gjashtëmilion e njëqind e tetëdhjetë e njëmijë e dyqind) **lekë pa TVSH**.
- 3. Operatori Ekonomik (OE) “SARK” Shpk**, me NIPT K52531415H, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,273,000** (gjashtëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e tremijë) **lekë pa TVSH**.

4. Operatori Ekonomik (OE) “ZEQIRI” Shpk, me NIPT J67902827A, me ofertë ekonomike në shumën prej **5,691,600** (pesëmilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm përkatësisht për arsyet:

1. OE “SARK” Shpk, me NIPT K52531415H, me ofertë ekonomike në shumën prej **6,273,000** (gjashtëmilion e dyqind e shtatëdhjetë e tremijë) **lekë pa TVSH**, skualifikohet nga kjo procedurë pasi është në kushtet detyruese për skualifikim, parashikuar nga neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”. Konkretisht, në pikën 3, gërma “dh”, të nenit 76, parashikohet se:

“3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

... dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;”.

Në interpretim të dispozitës së mësipërme, KVO i referohet procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kontenerë për mbetjet urbane”, me numër reference REF-07189-10-05-2021, procedurë në të cilën “SARK” shpk është shpallur fitues, por në datë 02.11.2021 ka njoftuar në sistemin e prokurimit elektronik se tërhiqet nga nënshkrimi i kontratës.

*** * ***

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“ZEQIRI” Shpk**, me NIPT J67902827A, me adresë qendrore sipas QKB: Lagjja “Bishanak”, Rruga “Skenderbeu”, Zona Kadastrale 5532, Banese private, Pasuria nr. 1/1088, Kati I-re, FIER, se oferta e paraqitur, me vlerë totale prej **5,691,600** (pesëmilion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e njëmijë e gjashtëqind) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109, të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ
(Me Urdhër Nr.153, Datë 08.06.2022 “Për delegimin e kompetencave...”)

Zamir Malasi